



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

VENDIM
Nr. 173, datë 22.04.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94/1, 95 e 97/3 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat si vijon:

1. Kërkesës nr. 181 prot., datë 02.03.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Padiës: {...}, i paditur: {...}, objekti: “Kthim sendi sipërfaqe toke”;
2. Kërkesës nr. 209 prot., datë 16.03.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}; objekti: “Heqje zotësie për të vepruar”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Alma Kodraliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen gjyqësore me Padiës: {...}; I paditur: {...} etj; Objekti: “Lirim dhe dorëzim sendi”.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Luan Lusha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...}; Objekti: “Ndreqje gabimi”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: {...} Tiranë; Objekti: “Njohje e të drejtës së pronësisë”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Lëshim i urdhrin të ekzekutimit”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesës nr. 135 prot., datë 08.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Paditës {...}; i paditur {...}; me objekt: “Detyrimin e të paditurit {...} (i pandehuri) për të dëmshpërblyer trashëgimtarët e viktimës së veprës penale për dëmin pasuror e jopasuror të pësuar si rezultat i vrasjes së babait të paditësit nga i padituri”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Alma Ahmeti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; Objekti: "Gjykimin e procedimit penal me nr. 166 të vitit 2020, në ngarkim të të pandehurit {...}i akuzuar per kryerjen e veprës penale te "Dhunës ne familje", parashikuar nga neni 130/a/1 të Kodit Penal".

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me paramendim”, parashikuar nga nenet 78/1, 278/1, 280 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: Vjedhje me armë.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Yrfet Shkreli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} etj; Akuza: “Prodhim dhe shitje narkotikësh”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; I pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Vjedhje me dhunë, prodhim dhe shitje narkotikësh”.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Yrfet Shkreli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}, etj; I paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror”.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekt: “Njohje bashkëpronar”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Saemira Hila, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kundërshtim i vendimit për mosfillimin e procedimit penal”.

GJYKATA E POSACME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si vijon:

1. Kërkesës nr. 456 prot., datë 13.04.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: I pandehur: {...}, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 278/1, 333/a/2, 334/1, 285-25 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Padi të: {...}; Të paditur: {...} etj; Objekti: Kundërshtim vendimi.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Kërkues/Padi të: {...}; Objekti: Përrjashtim gjyqtari.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Rishikim vendimi civil”.

4. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Padi të: {...}shpk; Të paditur: {...}; Objekti: “Kthim shume”.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Padi të: {...}; Të paditur: {...} etj; Objekti: “Pushim cënimi etj”.

6. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: Shkatërrim prone nga pakujdesia.

7. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Ankues/Kërkues: {...}; Objekti: “Kundërshtim vendim mosfillimi”.

8. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} etj.; Akuza: “Mashtrim kryer në bashkëpunim”.

9. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Objekti: Rishikim vendimi penal.

10. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi dhe Engert Pëllumbi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: Prodhim dhe shitja e narkotikëve.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Trafikim i narkotikëve”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...} ; Objekti: Lirim me kusht.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Vrasje me dashje, moskallëzim krimi”.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; I dënuar: {...}; Objekti: Njohja e vendimit penal të huaj nr. {...}, datë 19.12.2012 të Gjykatës së përbërë me BE Karditsa të dhënë ndaj shtetasit {...}.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Zëvendësim mase sigurimi personal.

6. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria Korçë; Shtetas nën hetim: {...}; Trashëgimtarë të viktimës: {...}; Objekt: Pushimin e çështjes që i përket procedimit penal nr. {...}, viti 2020, me objekt hetimin e vepresn penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”.

7. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria Korçë; Objektiv: Kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. {...}, vit 2020, të Prokurorisë së Rrethit gjyqësor Korçë, të regjistruar në ngarkim të personit nën hetim {...}; Viktima: {...}.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi (relatore), Sokol Pina dhe Miranda Andoni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Ankim kundër vendimit nr. {...} prot., datë 21.12.2020 të prokurorit “Për mosfillimin e procedimit penal nr. {...}, datë 02.12.2020”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Objekti: Njohje vendimi penal i huaj.

2. Gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Përjashtim gjyqtari

GJYKATA E APELIT TIRANË

1. Gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë, Arta Duka dhe Dritan Hasani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen civile me Padietës: {...}; I paditur: {...}, {...}, {...}” sh.p.k.; Palë e tretë: {...}; Objekti: “Kundërshtim i veprimit përmbarrimor nr. {...} prot., datë 12.01.2015 të Zyrës Përmbarrimore {...}

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR